



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:051109

Datë: 01.06.2022

Numri i dokumentit: 03086684

C.nr.990/20

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN -Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtares Liridona Haziri Mustafa, me bashkëpuntoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses S. Rr. nga fshati .. Komuna e Kamenicës, të cilin me autorizim e përfaqëson Av.Freskim Musliu nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Burim Maliqi Zyrtar i Lartë Ligjor në Komunën e Gjilanit, me objekt kontesti: Kompensim i shpenzimeve të ushqimit dhe i shpërblimit jubilar, vlera e objektit të kontestit 1,341.75euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarëve të palëve ndërgjyqëse, më datë 18.05.2022 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses S. Rr. nga fshati ... Komuna e Kamenicës Komuna e Gjilanit **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kërkesës për kompensim të shpenzimeve të ushqimit ditor t’ia paguaj shumën prej 1,332.00 euro, si dhe në emër të kërkesës për kompensim të shpërblimit jubilar, për mbi 20 vite përvojë pune, t’ia paguaj shumën prej 315.75 euro, apo shumën e përgjithshme prej 1,647,75euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit–Drejtoria e Arsimit, që paditëses S.Rr. nga fshati ... Komuna e Gjilanit, t’ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: 104 euro për përpilimin e padisë, 31 euro për taksë gjyqësore për padinë e parashtruar, dhe 135 euro për përfaqësimin e paditëses nga avokati për një seancë gjyqësore, apo shumën e përgjithshme prej 270 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit më dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja S. Rr. nga, përmes të autorizuarit të saj, Freskim Musliu avokat nga Gjilani, ka parashtruar padi në këtë gjykatë me datë 10.04.2020, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale për Arsim, me objekt kontesti kompensim i shpenzimeve të ushqimit, dhe shpërblimit jubilar.

I autorizuari i paditëses gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe precizimit të kërkesëpadisë të datës 29.04.2022, duke kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit, Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kërkesës për kompensim të shpenzimeve të ushqimit ditor t’ia paguaj shumën prej 1,332.00 euro, si dhe në emër të kërkesës për kompensim të shpërblimit jubilar, për mbi 20 vite përvojë pune, t’ia paguaj shumën prej 315.75 euro, apo shumën e përgjithshme prej 1,647,75euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm

Për vërtetimin e pretendimeve të saj, gjykatës i ka propozuar që si prova materiale t’i administroj dhe atë : Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me nr. të protokollit .. të datës .., Vërtetimin e përvojës së punës nga SHFMU “ ..” në fshatin .. me numër .. I datës .., kartela e Sindikatës së Arsimit në Kosovë, formulari për kërkesë me numër 05-.../20 i datës 05.02.2020, së bashku me kërksen drejtuar paditëses, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “ ...” në fshatin .. me numër .. I datës 27.01.2021 për periudhen kohore nga data 18.04.2017 -1.03.2020, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “ ...” në fshatin me numer 28/2022 i datës 07.02.2022 për periudhen kohore nga data 14.09.2020 – 16.04.2021, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “ ..” në fshatin .. me numër ... I datës 08.02.2021, për mungesë kuzhine.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës në mënyrë të specifikuar.

E paditura Komuna e Gjilanit, përmes përgjigjes në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqesor të mbajtur me datë 18.05.2022, e përfaqësuar sipas autorizimit nga Zyrtari ligjor i saj Burim Maliqi, ka theksuar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetimin se kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore në këtë çështje juridike kontestimore për të vendosur lidhur me kërkesëpadinë, ngase e njëjta konsideron se kompetente për të vendosur sipas kësaj çështje është Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, e jo Gjykata Themelore në Gjilan, pasi që e njëjta konsideron se pavarësisht se a është përgjigjur apo jo në kërkesën e paditësit DKA-ja, respektivisht e paditura, paditësi ka pasë mundësi që mbi bazën e përgjigjes së DKA-së dhe për shkak të heshtjes administrative në afat ligjor t’i drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamentit për Çështje Administrative. Po ashtu ka theksuar se paditësi kërkesëpadinë e tij e bazon në KKAK, të datës 18.04.2017, respektivisht në dispozitat e nenit 35, paragraf 7 dhe 8 të kësaj kontrate. Si arsye tjetër ka cekur se kësaj kërkesëpadie i mungon baza ligjore sipas Ligjit të Punës, referuar nenit 20 paragraf 2 dhe KKAK në fuqi nuk është e harmonizuar me Ligjin e Punës, ngase paditësja nuk ka orar të plotë të punës ashtu siç parashihet në dispozitat e këtij ligji dhe norma e plotë e punës për ditë pune sipas këtij ligji është 40 orë në javë. Më tej ka theksuar se kjo kërkesëpadi është në kundërshtim edhe me nenin 38 të kësaj kontrate nga fakti se punëdhënësi dhe SBASHK janë të obliguar ti shmangen çdo veprimi i cili ndikon në pamundësinë e zbatimit të kësaj kontrate, e në këtë rast kemi shkelje të këtyre dispozitave nga ana e sindikatës konform nenit 5,37 dhe 38 të Kontratës Kolektive, sepse nuk kanë mundur mbrojtjen ligjore të punëtorëve përmes përfaqësuesve ligjor të sindikatës, sepse në këtë formë dëmton buxhetin

duke paguar avokatë po ashtu ka shtuar se sipas nenit 90, paragrafi 8 të Ligjit të Punës, për të qenë kontrata në fuqi ligjore duhet të jetë e regjistruar në MPMS, kurse në rastin konkret kjo kontratë nuk është e regjistruar në organin e lartëcekur dhe në fund ka shtuar se nuk janë shtjerrë mjetet juridike sipas procedurës administrative me qëllim që të inicohet procedura gjyqësore për realizimin e të drejtës së paditëses, më tej ka shtuar se kjo kërkesë është parashkruar edhe konform ligjit të punës neni 78 pika 1 ngase nuk është adresuar asnjë kërkesë punëdhënsit dhe që në procedurë administrative të realizojë këtë të drejtë e që mendojmë se kjo çështje është primare që të zgjidhet paraprakisht para se të dorëzohet padi në gjykatë, nuk janë shtjerrë mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative, neni 79 i cili parashef afatin prej 30 ditëve të realizimit të kësaj kërkesë si dhe neni 82 të këtij ligji që specifikon inspektoratin e punës si autoritet zyrtarë të zgjidhjes së kërkesave të kësaj natyre. I njëjti gjatë seancën kryesore I njëjti po ashtu i kundërshtuar edhe vërtetimin nr.28/22 të datës 07.02.2022, me arsyetimin se figurojnë ditë të punës pas skadimit të Kontratës Kolektive, konkretisht pas datës 18.04.2020, e po ashtu edhe për vitin shkollor 2019/20 figurojnë më tepër ditë se që janë të parapara në kalendarin shkollor të lëshuar nga MASHT. Nga arsyet e cekura, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pabazuar.

Nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore i ka administruar këto prova materiale: Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me nr. të protokollit ... të datës 01.09.2015, Vërtetimin e përvojës së punës nga SHFMU “...” në fshatin ... me numër ... i datës 15.01.2020, kartela e Sindikatës së Arsimit në Kosovë, formulari për kërkesë me numër 05-... i datës 05.02.2020, së bashku me kërksen drejtuar paditëses, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “...” në fshatin ... me numër ... i datës 27.01.2021 për periudhen kohore nga data 18.04.2017 -1.03.2020, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “...” në fshatin ... me numër ... i datës .. për periudhen kohore nga data 14.09.2020 – 16.04.2021, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “...” në fshatin ... me numër i datës 08.02.2021, për mungesë kuzhine.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Në bazë të Kontratës së punës me kohë të pacaktuar me nr. ... të datës ..., gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në SHFMU “...” në fshatin ..., në pozitën e mësimdhënës i TIK-ut me 20 orë.

Në bazë të Vërtetimit për përvojën e punës nga SHFMU “...” në fshatin ... me numër ... i datës 15.01.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka 20 vite përvojë pune.

Nga kartela e Sindikatës së Arsimit në Kosovë, gjykata vërtetoi faktin se paditësja është anëtare e kësaj Sindikate.

Në bazë të formularit për kërkesë me numër 05-.... i datës 05.02.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësja i është drejtuar të paditurës me kërkesë të paditurës për kompensimin e pagave.

Në bazë të vërtetimit të lëshuar nga SHFMU “...” në fshatin numër .. i datës 27.01.2021 për periudhen kohore nga data 18.04.2017 -1.03.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka gjithsej 539 ditë pune për vitet shkollore 2016/17.2017/18.2018/19 dhe 2019/20.

Në bazë të vërtetimit të lëshuar nga SHFMU “...” në fshatin .. me numer .. i datës 07.02.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka gjithsej 127 ditë pune për periudhen kohore nga data 14.09.2020 – 16.04.2021.

Nga vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “...” në fshatin .. me numër 54/2021 i datës 08.02.2021, gjykata vërtetoi faktin se kjo shkollë nuk posedon kuzhinë.

Me nenin 90 të Ligjit të Punës (në vijim: LP), është paraparë se “1.Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:2.1. nivel të vendit,2.2. nivel të degës,2.3. nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”, ndërsa me nenin 4, parag. 2 të po këtij ligji, është paraparë se: “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”. Po ashtu, sipas nenit 8, parag. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD), është paraparë se “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”.

Sipas nenit 35, parag. 7 të KKA-së është paraparë se “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarin që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarëve, përmes restaurantit a kuzhinës, osë në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit” kurse sipas nenit 35, parag. 8, pika 8. të kësaj Kontrate, është përcaktuar qartëse “Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë prej: për 10 vite të përvojës së punës në vlerë të 50 % të një page bazë”, ndërsa me pikën 8.5 të po këtij neni parashihet se “Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarin i ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse”

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe duke pas parasysh edhe faktet jokontestuese nga palët ndërgjyqëse në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara ka vërtetuar faktin se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht punon si mësimdhënës e ciklit klasor në SH.F.M.U “...” në fshatin ..., ka mbi 20 vite përvojë pune, dhe si ditë të pranisë në punë ka 666 ditë pune. Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, dhe duke u bazuar në nenin 35 parag. 7 dhe 8 pika 8.1 të KKA-së, gjykata gjeti se paditësit në emër të kërkesës për kompensim të shpenzimeve të ushqimit ditor i takon e drejta në kompensim nga 2 euro për një ditë pune, gjë që, për 666 ditë të pranisë në punë, gjykata i ka aprovuar shumën e kërkuar prej 1,332euro (llogaritur: 666 ditë pune x 2 euro për një ditë = 1,332euro), kurse në emër të kërkesës për

shpërblim jubilar, gjykata gjeti se paditësest në emër të kësaj kërkesë i takon e drejta në kompensim të 75% të një page bazë sa e ka paditësja (421 euro paga bazë sipas Listës së pagave x75% =315.75euro), gjë që, gjykata paditësja i ka aprovuar shumën e kërkuar prej 315.75euro.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e të paditurës lidhur me kundërshtimin e kompetencës lëndore të kësaj gjykate, por gjykata konsideron se kjo çështje juridike është në kompetencë të Gjykatës Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, e jo në kompetencë të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, pasi që të drejtat dhe detyrimet dhe raportet në mes palëve ndërgjyqëse janë të rregulluara me Ligjin e Punës, e rrjedhimisht edhe me KKAK-në. Për më tepër sipas nenit 2, parag. 2 të Ligjit të Punës, në mënyrë shprehimore është cekur: “Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës”, e në rastin konkret ligjet e veçanta të cilat e rregullojnë këtë fushë nuk kanë paraparë ndonjë mënyrë tjetër të zgjidhjes së kontesteve për këtë kategori të të punësuarve, e rrjedhimisht për vendosjen e këtij kontesti në mes palëve ndërgjyqëse është e kompetencës lëndore kjo gjykatë. Për më tepër, gjykata gjatë gjithë procedurës sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore dhe nga arsyet e cekura më lartë vlerëson se kjo gjykatë ka kompetencë lëndore për të vendosur për këtë çështje kontestimore.

Lidhur me pretendimin e parashtruar nga e paditura se e njëjta nuk është nënshkruese e KKAK-së sepse kjo kontratë është lidhur në mes të Ministrisë së Arsimit dhe SBASHK-ut, dhe nga kjo arsye aludon se kjo kontratë nuk prodhon efekt juridik ndaj komunës së Gjilanit, këtu të paditurës, gjykata vlerëson se ky pretendim nuk qëndron dhe është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, pasi që KKAK është lidhur në nivel vendi sipas dispozitave të nenit 90 Ligjit të Punës, çka nënkupton se meqë KKAK është e lidhur në nivel vendi, e njëjta prodhon efekt juridik edhe ndaj komunës së Gjilanit, këtu të paditurës. Pos kësaj, edhe me nenin 2 parag.1 pika 1.1 të KKAK-së, në mënyrë shprehimore është paraparë se: “Dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet e Arsimit Parauniversitar....”, ndërsa me pikën 1.2 të po këtij neni, është cekur se: “Dispozitat e kësaj Kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (Komunat-DKA, KD të Universitetëve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj)...”. Në interpretim të kësaj dispozite, gjykata vlerëson se e paditura ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga KKAK, pasi që me këtë dispozitë është cekur qartë se të punësuarit por edhe punëdhënësit janë të detyruar t’i zbatojnë dispozitat e kësaj kontrate, andaj edhe të njëjtët janë përgjegjëse në përmbushjen e detyrimeve të cilat dalin nga KAKA.

Sa i përket pretendimit tjetër të paditurës ku ka theksuar se ne bazë të nenit 90, pika 8 të LP për qenë kontrata në fuqi ligjore duhet të jetë e regjistruar në faqen e MPMS, dhe se njëjta nuk është regjistruar fare në faqen MPMS, dhe si e tillë nuk duhet të prodhoj efekt juridik, për gjykatën edhe ky pretendim është i pabazuar, sepse sipas vlerësimit të gjykatës nuk është relevante se a është regjistruar apo jo KKAK në faqen e MPMS, sepse referuar nenit 47 të kësaj kontrate është paraparë se pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët, e njëjta regjistrohet dhe depozitohet në MASHT e jo në ndonjë organ tjetër siç pretendon e paditura, kjo për faktin se kjo kontratë është sektoriale dhe jo e përgjithshme, dhe e njëjta prodhon efekt juridik vetëm për të punësuarit dhe punëdhënësit në sektorin e arsimit (neni 2 i Kontratës). Sido që të jetë, akti i regjistrimit dhe depozitimi i kontratave, sikurse kjo në rastin konkret i KKAK-së ka qenë përgjegjësi e karakterit administrativ e organit publik kompetent që të njëjtën ta regjistroj apo depozitoj, e për të cilat lëshime eventuale nuk mund të kenë konsekuenca të punësuarit, e në këtë rast nuk mund të pësoj paditësja.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet dhe kundërshtimet e të autorizuarit të paditurës të cekura gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancën e mbajtur më datën 18.05.2022, se paditëses nuk i takon kompensimi për ushqim për ditët e pranisë në punë pas datës 18.04.2020, ditë këto të llogaritura sipas vërtetimit të datës me nr.të prot.28/22 të datës 07.02.2022, me arsyetimin se këto ditë janë të llogaritura pas skadimit të afatit të KKAK-së, por gjykata vlerëson se nuk qëndron një pretendim i tillë i të paditurës, pasi që me nenin 45 të KKAK, shprehimisht është paraparë se: “Nga Kontrata Kolektive, palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese, e cila tërheqje fillon së zbatuari ditën e nënshkrimit të kontratës së re. Nëse nga Kontrata Kolektive pasi t’i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për 1 vit. Pas skadimit të afatit të kontratës kolektive, lidhet kontratë e re. Në fillimin e punës së kontratës së re në gjashtëmuorin e parë përdoren rregullat dhe dispozitat e kontratës së vjetër”. Në rastin konkret përderisa nuk kemi kontratë të re të nënshkruar nga palët ndërgjyqëse dhe nuk kemi tërheqje nga KKAK të asnjërës palë, bazuar nga neni i lartcekur i KKAK, mund të përfundohet se dispozitat e kësaj kontrate janë akoma në fuqi dhe kjo kontratë prodhon efekt juridik për palët kontraktuese, deri në nxjerrjen dhe nënshkrimin e kontratës së re kolektive apo siç është cekur më lartë zbatimi i saj vazhdon edhe për 1 vit, e që bazuar edhe në Ligji i Punës, dispozitat e të cilit ligj, zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës, i cili ligj në nenin 90 parag. 6 ka paraparë edhe atë se: “Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e të paditurës ku është thirrë në parashkrim të kërkesës se paditëses, mirëpo, sipas gjykatës një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi paditësja padinë në gjykatë e ka paraqitur me dt.10.04.2020, pra, pas hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive të Arsimit, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit ka hyrë në fuqi me dt.18.04.2017, andaj nisur nga rrethana të tilla rezulton se paditësi nuk ka pasur bazë ligjore për parashtrimin e një kërkesë të tillë para kësaj date, pra, para dt.18.04.2017, çka do të thotë padia është parashtruar në afatin ligjor të paraparë me nenin 87 të Ligjit të Punës, pasi që sipas nenit 87 të këtij ligji, në mënyrë shprehimore është paraparë se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”, andaj nga këto arsye rezulton se padia e paditësit është parashtruar brenda afatit ligjor prej 3 viteve, dhe rrjedhimisht kërkesëpasia e paditësit nuk është përfshirë në parashkrim ashtu siç pretendon e paditura.

Nga se u tha më lartë, duke pasë parasysh faktin se paditësit i ka lindur e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës së saj lidhur me kërkesën e parashtruar, e njëjta si palë e legjitimuar ka të drejtë që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, sepse, sipas nenit 245 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD) në mënyrë të qartë është paraparë se: “Kreditore në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, andaj, duke pasë parasysh të cekurat më lartë, gjykata gjeti se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj paditëses, ku edhe vendosi që ta detyrojë të paditurën që paditëses t’ia kompensojë shumën e kërkuar dhe të aprovuar nga gjykata si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë irrelevante në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata duke patur parasysh suksesin në procedurë të paditësit dhe duke u bazuar në nenin 449, 452 dhe 463, parag. 1 të LPK-së dhe nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, të datës 18.03.2017, ka aprovuar në tërësi kërkesën për shpenzimet e kërkuara nga i autorizuari i paditësit, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: 104 euro në emër të përpilimit të padisë, 31 euro në emër të taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë, si dhe 135 euro në emër të përfaqësimit të paditësit për një seancë gjyqësore, apo shumën e përgjithshme prej 270 euro.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.990/20, me datë 18.05.2022

Gjyqtarja,
Liridona Haziri Mustafa

UDHËZIMI JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate.